




**NDRYSHIMI
VJEN PËRMES PUNËS**



**ISLAMI, DËSHMI
E TË DREJTAVE TË NJERIUT!...**



**ANIJA E SHPËTIMIT TONË
E KA EMRIN ISLAM!**


Viti XIV - Nr. 3 (157),
Mars, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

“DO TË KONSIDEROHEM TRADHËTAR NËSE HESHT!”



*Islami ka dhënë zgjidhjet e tij,
për t'i dhuruar besimtarit kurajo,
qetësi, durim, urtësi, rehati shpirtërore,
si dhe për ta pajisur
me sekretet e përballjes me vështirësitë
e ditës; namazi i natës,
dhikri, salavatet, lutjet, namazet ditore,
leximi i vazhdueshëm
i Kur'anit etj. Feja është fakte konkrete,
argumente të qarta,
moral dhe sjellje, dëshmim i mirësive me të
cilat All-llahu i Madhëruar
na ka udhëzuar sesi ta jetojmë jetën larg
stresit, brengave,
shqetësimeve e tronditjeve emocionale
kalimtare e epsharake.
Në fakt, feja është stacioni i parë dhe i
fundit, i lumturimit në këtë botë
dhe në të përtejmen!*



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut të Madhëruar, Krijuesit të gjithësisë, që krijoi dhe përsosi, udhëzoi dhe plotësoi, i dhuroi njeriut bekimet pafund të përmendjes së Emrave të Tij, pa ndërmjetës, pa ndërlikohës, pa ndërhyrës... Thotë në Kur'anin Famëlartë: "Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte"¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë, zotërsisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), të dërguarit mëshirë për mbarë botët; këshillues dhe qortues, udhërrëfyes drejt rrugës së drejtë, pas së cilës nuk ka devijim e dëshpërim!

TË DASHUR VËLLEZËR BESIMTARË,

Po lexoja para pak ditësh në shënimet e njërit prej thirrësve të shquar islamë të kohës tonë, ku gjeta edhe këtë këshillë interesante, që dëshiroj të jetë mesazhi i kësaj jave. Shkruan: "Nëntë gjëra të ndihmojnë në jetën tënde të përditshme:

1. Dëshiron lumturinë? Fale namazin në kohën e vet.
2. Dëshiron dritën e fytyrës? Fal namaz nate.
3. Dëshiron rehatinë? Lexo Kur'an.
4. Dëshiron shëndetin? Agjëro.
5. Dëshiron rrugëzgjdhje? Shtojë istigfarin. (Estagfirull-llah)
6. Dëshiron largimin e brengës? Lutu.

1. Kur'ani, El-Alak: 5.

"NËNTË GJËRA QË TË NDIHMOJNË NË JETËN TËNDE TË PËRDITSHME"

7. Dëshiron sosjen e vështirësisë? Thuaj: La haule ve la kuvvete il-la bil-lah.

8. Dëshiron begatinë? Bjer salavatë për të dërguarin.

9. Dëshiron të shpërblehesh pa u lodhur? Mos i mbaj për vete këto mirësi, shpërndaji për hir të All-llahut, duke i konsideruar si një sadaka rrjedhëse, që do të shkruhet në peshoren e veprave tuaja."²

U ndala pak. Zakonisht, ne jemi të ftuar që fjalët e kujtdo prej njerëzve të shquar të fesë, prej të parëve e deri tek më të afërmit në kohë, t'i peshojmë me Kur'an dhe me fjalët e të dërguarit; nëse kanë një bazë, i vlerësojmë dhe i marrim në konsideratë, përndryshe, i kalojmë si urtësi, të cilat nuk jemi të obliguar t'i zbatojmë as t'i "shenjtërojmë", siç bëjmë shpesh me fetva të ndryshme, thënie dijetarësh etj.!

Ajo që dua nëpërmjet hytbes së kësaj jave, është tërheqja e vëmendjes drejt mirësive pa fund, që na janë dhuruar për ta jetuar jetën mbi bazën e rregullit, jo në mënyrë anarkike. Nuk dua të bëj analizën e 9 pikave të lartshënuara, do shkonte gjatë, por dua të ftoj secilin prej jush ta shohim e ta lexojmë jetën ndryshe, para duarve të thirrjeve të fesë tonë islame.

Realitetet e jetës së njeriut të kësaj kohe, janë realitete të mbushura me stres, me lodhje, me prekje frike, me mungesë sigurie, me mosbesim, me paragjykim, me ankth, me shqetësim e brenga pa fund. Në Shqipëri, ka mbi 100 vite, që shoqëria noton në këto ujëra të turbullta, me siguri të lëkundur, pa ekonomi të qëndrueshme, me persekutimtim ndaj fesë, me padrejtësi e shturje të pushteteve, por jo vetëm kaq.

Për këtë, Islami ka dhënë zgjidhjet

2. Në publikimet online në faqen zyrtare të Dr. Omer Abdulkafi, në gjuhën arabe.

e tij, për t'i dhuruar besimtarit kurajo, qetësi, durim, urtësi, rehati shpirtërore, si dhe për ta pajisur me sekretet e përbaljes me vështirësitë e ditës; namazi i natës, dhikri, salavatet, lutjet, namazet ditore, leximi i vazhdueshëm i Kur'anit etj.

VËLLEZËR BESIMTARË,

Falja e namazit në kohën e vet, nuk është thjeshtë një angazhim disiplinor për kryerjen e disa lëvizjeve gjimnastikore të shoqëruara me leximin e disa teksteve të shenjta kur'anore, siç e perceptojnë shumë praktikues të namazit, namazin.

*ISLAMI KA DHËNË
ZGJIDHJET E TIJ,
PËR T'I DHURUAR
BESIMTARIT KURAJO,
QETËSI, DURIM, URTËSI,
REHATI SHPIRTËRORE,
SI DHE PËR TA PAJISUR
ME SEKRETET E PËRBALLJES
ME VËSHTIRËSITË E DITËS;
NAMAZI I NATËS, DHIKRI,
SALAVATET, LUTJET,
NAMAZET DITORE,
LEXIMI I VAZHDUESHËM
I KUR'ANIT ETJ.*

Ai është shtylla kryesore e fesë. Kuptimi i duhur i namazit dhe i veprimit të tij dhuron ndjesi të shumta, ku spikat ajo e mbikqyrjes së marrëdhënies me Zotin e gjithësisë, i Cili urdhëron: "... vërtetë namazi të ruan nga shturja dhe nga çdo vepër

e shëmtuar”³

Mendo për pak, kur ti zgjohesh herët në mëngjes, me nijet për ta nisur ditën me katër rekatet e sabahut (2 e 2), me lutjet e një dite të re plot mbarësi e mirësi, a nuk e ke për detyrë t’i kërkosh llogari vetes që të ruhet për të mos shkelur në ndalesat e Atij Zotit, të Cilit iu nënshtrua që në sabah, besën e të Cilit do të ripërtërijë pas disa orësh në ndalesën e dytë të namazit ditor, atë të mesditës? Poashtu deri në kohën e iqindisë, akshamit e jacisë, me të cilën e mbyll ditën? Pra, a nuk është namazi i drejtë në vetëvete një hapësirë lumturimi, që të fal garanci dhe të jep kurajo të vazhdueshme në jetë?

Ky lloj njeriu, që ditën e nis me lutje e nështrim para duarve të Krijuesit të vetëm të universit, a mund të jetë mashtrues dhe i padrejtë me tjetrin, kushdo qoftë ai? A mund të jetë zemërkeq e nihilist? A mund të jetë hileqar e gojëprishur? Absolutisht, jo!

Nga ana tjetër, shpesh shohim e dëgjojmë muslimanë pa namaz, pa haxh, pa agjërim, pa zekat... Dhe ka të drejtë kush pyet i habitur: “Çfarë feje, pa namaz?! Dhe çfarë kuptimi ka përkatësia islame pa namaz? Themi muslimanë, por nuk falemi, ose neglizhojmë namazin, ose e lëmë fare namazin. Po ku është Islami këtu? Ku është sinjeriteti me Allahun?”⁴

Kujtoj një djalë të ri, mjek musliman. Shkova të bëj një vizitë dhe kur e pyeta për takimin e radhës, ma ktheu: “Këtu jam zakonisht, përveç kohëve të namazve, kur dal për t’u falur te xhamia më afër klinikës! Bëj një pushim 15 minutësh...”

Ky është modeli, ky është lumturimi i natyrshëm që të jep Islami!

Sepse namazi, përveç se është themeli i marrëdhënies me Zotin dhe shtylla kryesore që e mban zemrën e besimit në jetë, është edhe

3. Kur’ani, El-Ankebut: 45. (version i përkthimit të kuptimeve të Kur’anit nga H. Hasan Nahi).

4. Aid El-Karni, “El-misku vel-anber fi khutabil-minber”, botimi i parë, Egjipt, 2005, f. 222.

FEJA ËSHTË FAKTE KONKRETE,

ARGUMENTE TË QARTA,

MORAL DHE SJELLJE,

DËSHMIM I MIRËSIVE

ME TË CILAT

ALL-LLAHU I MADHËRUAR

NA KA UDHËZUAR

SESI TA JETOJMË JETËN

LARG STRESIT, BRENGAVE,

SHQETËSIMEVE E TRONDITJEVE

EMOCIONALE KALIMTARE

E EPSHARAKE.

NË FAKT, FEJA ËSHTË STACIONI

I PARË DHE I FUNDIT,

I LUMTURIMIT NË KËTË BOTË

DHE NË TË PËRTEJMEN!

dëshmi komunitare; e kundërta e hipokrizisë. Për këtë, Resulull-llahu thoshte: “Diferenca në mes nesh dhe tyre është namazi, ai që e lë atë ka mohuar Zotin!”⁵ Jo për të bërtitur disa djelmossa të paformuar: “E kam babën qafir, se nuk falet!”, jo, kjo është mungesë edukate në hak të kujtdo dhe banalizim i fesë dhe i hadithit në fjalë!

Hadithi i lartshënuar është thirrja më e fortë drejtuar muslimanëve për të ruajtur hakun e bashkësisë së tyre, nëpërmjet namazeve me xhemat në xhami! Është thirrja e shpirtit drejtuar mbarë muslimanëve, për t’u takuar pesë herë në ditë në xhami, sup më sup e dorë për dore. (Jo, inate primitive medhhebesh e kokëfortësi fetvashë, që nxjerrin vetë fenë nga feja!?)

Shih pastaj jetën ekonomike, pozicionin në shoqëri, edukimin e brezit të ri, lidhjet shoqërore, gjuhën e komunikimit komunitar në mesin e muslimanëve dhe jashtë tyre, kur të jetë rregulluar namazi! Sepse është

5. Transmetuar nga Nesaiu dhe Tirmidhiu etj.

amaneti i Zotit, pragu, besa, shpirti!

“Namazi e bart të zotit drejt largimit nga shturja dhe lënia e veprave të shëmtuara, sipas përkushtimit dhe prezencës së zemrës së tij në namaz”⁶, thotë dijetari i shquar Shejkh Abdull-llah Siraxhuddin.

E pikërisht, tek vlera e namazit dhe tërheqja e besimtarëve të përkushtuar ndaj lutjes para duarve të Tij, edhe kur të tjerët flenë, thotë në Kur’an: “Ata qenë të cilët pak flinin natën. Dhe në syfyr (nga mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet”⁷

Ndërsa Resulull-llahu (a.s) thoshte: “Faleni namazin e natës, sepse ai është traditë e njerëzve të mirë para jush, është afrim me Zotin tuaj, fshin gabimet, ndalon gjynahin!”⁸

I lumi ai që udhëzohet drejt namazit të natës, sexhdes së gjatë e lutjes në qetësi, para duarve të Zotit të gjithësisë! I lumi ai, që i përgjigjet Resulull-llahut (a.s) teksa udhëzon: “Më afër, ku mund të jetë njerri me Zotin e vet, është në momentin, kur është në sexhde, prandaj shtojeni lutjen!”⁹

TË DASHUR VËLLEZËR,

Feja është fakte konkrete, argumente të qarta, moral dhe sjellje, dëshmim i mirësive me të cilat All-llahu i Madhëruar na ka udhëzuar sesi ta jetojmë jetën larg stresit, brengave, shqetësimeve e tronditjeve emocionale kalimtare e epsharake.

Në fakt, feja është stacioni i parë dhe i fundit, i lumturimit në këtë botë dhe në të përtejmen!

(Hytbe e mbajtur në xhaminë e Plumbit)

Shkodër, më 11 mars 2016.

6. Abdull-llah Siraxhuddin, “Et-tekarribu ilall-llah”, botimi i parë, Haleb, 1991, f. 27.

7. Kur’ani, Edh-Dharijat: 17. (version i përkthimit të kuptimeve të Kur’anit nga H. Sherif Ahmeti).

8. Transmetuar nga Tirmidhiu, nga sahabiu Ebu Umame (r.a).

9. Transmetuar nga Muslimi, nga sahabiu Ebu Hurejra (r.a).



Sheikh Muhamed El-Gazali

Disa ajete kërkojnë maturi dhe thellësi mendimi në mënyrë që të qartësohet kuptimi i tyre, veçanërisht në qoftë se gabimi në to përbën rrezik të madh për jetën shoqërore. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "Pasuria dhe fëmija janë zbukurim i jetës së kësaj bote, ndërsa veprat e tjera të vlefshme dhe të mira janë shpresë dhe shpërblim te Zoti yt."¹

Ky krahasim nuk është bërë ndërmjet dy të kundërtave përballë njëra-tjetrës, sepse ndoshta i privuar nga pasuria dhe fëmija nuk ka për të ahiret dhe ndoshta i kënaqur me pasuri dhe fëmijë tek Allahu ka gradë të lartë...

Njerëzit e thjeshtë mendojnë se atyre që u është dhënë pasuri dhe fëmijë nuk kanë vend tek Allahu, ose vendi i tyre do të jetë i ultë aq sa u është dhënë mirësi në dynja, sikur varfëria është kusht për të hyrë në xhenet dhe fitore për një përfundim të mirë.

Ky është një konceptim i rremë

1. Sureja Kehf: 46

KONCEPTIM I RREMË PËR ISLAMIN

AJO, QË ISLAMI REFUZON ËSHTË LAKMIA, PANGOPËSIA E TEPRUAR PËR KËTË JETË, TOPITJA NGA AJO QË NDODHET PAS SAJ DHE MUNGESA E PËRGATITJES PËR TË.

ndaj Islamit, i cili qe përhapur përgjatë disa brezave duke fundosur shtetin e ymetin dhe duke humbur fenë e dynjanë së bashku...

Ajo, që Islami refuzon është lakmia, pangopësia e tepruar për këtë jetë, topitja nga ajo që ndodhet pas saj dhe mungesa e përgatitjes për të. Ndërsa në qoftë se njeriu furnizohet me kapital e pasuri dhe me to mbështet pozicionin e ymetit në botën e ekonomisë, kontribuon më shumë se të tjerët duke mbuluar dhe plotësuar nevojat e saj, padyshim që gjithë veprimtaria e tij, gjerë e gjatë llogaritet prej veprave "të tjera të vlefshme".

Një njeri i tillë duhet të merret si shembull, madje shpresë e dëshiruar dhe vend i kërkuar, madje kjo gradë e tij duhet të kihet zili, ashtu siç ka ardhur në hadithin e saktë²...

Ah, sikur myslimanët, një numër i madh i tyre të ishin prej këtyre biznesmenëve të suksesshëm, me të cilët të mbrohet thirrja dhe të mundesh të mbështetesh në kontributin dhe mirësinë e tyre!

Ky lloj i lartë është gjë tjetër ndaj atij lloji, i cili ka ardhur në këtë ajet: "Dhe, mos i hidh sytë tek ata, të cilëve Ne u kemi dhënë kënaqësi palë-palë

2. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Nuk lejohet zili, përveçse në dy gjëra: Personit, të cilit Allahu i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon atë, ditë natë (në rrugën e Allahut)..."

të zbukurimeve të kësaj bote për t'i sprovuar me to. E, risku i Zotit tënd është më i mirë dhe i përhershëm."³

Të tillë njerëz kanë harruar Allahun dhe takimin e Tij, duke u zhytur në kënaqësitë e dynjasë të përkohshme e duke mos grumbulluar asgjë për të nesërmen e tij. Ndoshta besimtari i varfër e shikon atë dhe mashtrohet prej mirësisë së tij të dukshme dhe fillon e shqetësohet për gjendjen e vështirë që ka. Prandaj edhe është ndaluar të hedhë këtë lloj shikimi të shkurtër dhe i tërhiqet vëmendja prej këtij mashtrimi të papërfillshëm.

Kam parë disa injorantë, të cilët as që duhet të lejohen të flasin për Islam, e gurëzojnë shoqërinë me gjurmë që nuk i kanë kuptuar dhe nuk dinë asgjë për ndërlidikimet dhe argumentimet e tyre, duke u thënë njerëzve "Banorët më të shumtë të zjarrit janë të pasurit. Gjithashtu edhe femrat janë pjesa më e madhe e banorëve të tij, duke lënë për të kuptuar se pasuria dhe femërorja janë mëkat..."

Këto janë fjalë boshe, me kuptim e ndikim të shëmtuar, por tashmë ka ardhur koha që të distancohemi prej tyre dhe t'i këshillojmë ata që i thonë e i pohojnë, të heshtin e të pendohen.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

3. Sureja TaHa: 131

AH, SIKUR MYSLIMANËT, NJË NUMËR I MADH I TYRE TË ISHIN PREJ KËTYRE BIZNESMENËVE TË SUKSESSHËM, ME TË CILËT TË MBROHET THIRRJA DHE TË MUNDESH TË MBËSHTETESH NË KONTRIBUTIN DHE MIRËSINË E TYRE!





Xhahid Bushati, shkrimtar

Njëri nga bashkëpunëtorët e ngushtë të revistës “Zani i Naltë”, që në fillesat e saj dhe në disa numra më pas, qe dhe Hafiz Ali Korça. Nderimi për veprën e tij është pak të thuash nderim. Mbase duhet kërkuar ndonjë fjalë tjetër magjike në fjalorë, epistolarë a enciklopedi. Burrë i ditur, burrë i mençur. Me një diapazon të gjerë kulture dhe rrezatim diturie. Nga ata burra, ndonëse të pakët të kësaj natyre tipologjike nderojnë Kombin, pavarësisht se ende nuk ka marrë vlerësimin “Nderi i Kombit”.

Poliedriciteti i figurës së tij, më sjell ndërmend Nolin e Madh. Atdhetar dhe luftëtar në Lëvizjen kombëtare, kontribues i pasqorë në fushën e arsimit, të gjuhës, të letërsisë për fëmijë. Gjithashtu, kontribues i pasqorë në lëmin e historisë, islamistikës, kulturës (poet e përkthyes), publicistikës, filozofisë, etj. Me një rrugë të gjatë, të mundimshme me plot dhembje e sakrificë. Si askush.

Në këtë rrugë të gjatë, teksa Hafizi i nderuar shpërndante rrezatimin e diturisë së tij, erudicionin dhe poliglotësinë, kurrë nuk e kishte menduar se do të kishte ditë dhe vite, që Ai do të njihej edhe me fjalët e tmerrshme: harresë, shpërfillje, periferi, joprotagonist, izolim, burg, drobitje, mjerim, tragjizim, dëshpërim, etj. Po citoj këto dy fragmente për të përligjur argumentet e mësipërme. Fragmenti i parë: “Një plak krenar, me shtat të bëshëm, me mjekër të zezë e çallmë mbi kokë, me xhybe të zezë, përplot

HAFIZ ALI KORÇA - NJËRI NGA BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS “ZANI I NALTË”

Burrë i ditur, burrë i mençur. Me një diapazon të gjerë kulture dhe rrezatim diturie. Nga ata burra, ndonëse të pakët të kësaj natyre tipologjike nderojnë Kombin, pavarësisht se ende nuk ka marrë vlerësimin “Nderi i Kombit”.

fuqi e i pathyeshëm, dukej Ai pas Luftës së Dytë Botërore.” Fragmenti i dytë: Kur u internua në Kavajë. “... dukej i molisur, i lodhur shpirtërisht e fizikisht, i izoluar në këtë qytet të vogël. ... Vitet e fundit ndjehej i braktisur.”

Hafiz Aliu ruajti në substancën e emrit dhe mbiemrit të tij, si gur të çmuar fjalën e bukur shqipe: Korça. E përjetësoi. Më sjell ndërmend Lasgushin, poetin modern të letrave shqipe. Poradecin e tij të dashur e të shtrenjtë edhe ai e gdhendi si mbiemër.

Hafiz Aliu, i nderuar!.. Foli dhe u shpreh shqipërisht në mënyrë të madhërishtme. Fund e krye. Me shqipen e zemrës, me shqipen e shpirtit, me shqipen-amanet; ndonëse në jetën e tij, në atë të lindjes kishte një prill, muaj që të kujton lulet; ashtu si në pragvdekjen e tij kishte një dhjetor që të kujton: acarin, dëborën e dhimbshme, të ftohtin, erën e tërbueme.


Hafiz Aliu, i nderuar!.. Në pragvdekjen e tij më kujton Migjenin. Se Hafizi qe një figurë tragjike, po ashtu dhe Migjeni – figurë tragjike. Se Hafizi pati një vatër drite që



HAFIZ ALI KORÇA

ndikoi në formimin e tij dhe quhej: Stamboll. Po ashtu edhe Migjeni – vatra e tij e formimit quhej Manastir.

Trashëgimia që na la Hafizin, është botuar si kolanë prej 12 veprash nga Shtëpia Botuese Logos A, në vitin 2006. Nderim për këtë Shtëpi Botuese! Akt fisnik i saj! Nuk ka panteon më të bukur se sa opusit jetëdhënës e diturues të Hafiz Ali Korçës, i ka bërë kjo Shtëpi Botuese!



“DO TË KONSIDEROHEM TRADHËTAR NËSE HESHT!”

Mëngjesin e sotëm po lexoja dëshminë e dijetarit dhe mendimtarit të shquar egjiptian, Shejkh Muhammed El-Gazali përpara gjykatës, me rastin e ndalimit dhe sekuestrimit të librit të tij me titull: “Lufta e fesë”, (Kajro, 1957).

Thotë: “Dola para gjyqtarit, që ishte një burrë i singertë, guximtar. Më tha: Ti je autori i këtij libri, “Lufta e fesë”? Pohova. Tha: A nuk të duket se në të ka ca kapituj dhe studime provokuese?”

Ia ktheva: Rëndësi ka të bindet gjykata për vërtetësinë e asaj që është thënë. E nëse ajo që kam shkruar është e vërtetë, s’ka pse të qortohem për të.

Tha: Mund të jetë e vërtetë, por jo çdo gjë që dihet, thuhet! Ndoshta, ajo që ke përmendur mund të trazojë shpirtin, ndërkohë ne kemi nevojë për qetësi.



Thashë: Kam rreshtuar emrat e xhamive të shembura vetëm në Kajro, me qëllim ndalimin e këtij shkatërrimi të qëllimshëm të shtëpive të All-llahut. Njëkohësisht, kam përmendur se vetëm në Egjiptin e ri ka 34 kisha dhe 7 xhami, vetëm kaq, edhe pse përqindja e muslimanëve është e madhe, ndërsa koptët janë më pak se 10%. Këto të dhëna i kam marrë nga Bashkia e Kajros, për vitin 1957.

Gjyqtari tha: Nuk kam çfarë të kundërshtoj për numrat, por mënyra e prezantimit nxit kundërshtime...

I thashë: Zotëria im, mund të ndodhë që një qytetar duke ecur rrugës, të shohë një hajdut që po mësyn derën e një dyqani, për ta thyer e vjedhur më pas. Mund të thojë me vete: Nëse e pengoj, ai mund të më godasë... Dhe kështu e

neglizhon dhe vazhdon rrugën e tij.

Ky frikacak, edhe mund të justifikohet. Por, çfarë mendimi keni nëse ai që largohet nga vendngjarja është një polic?! Ai konsiderohet tradhëtar, sepse detyra e tij është të ruajë rendin!

Gjyqtari tha: Shumë e vërtetë!

Ia ktheva: Edhe unë, në postin zyrtar që kam, jam mbrojtës i besimit; do të konsiderohem tradhëtar nëse hesht para shkatërrimit të xhamive, a dominimit mbi to!”

Ky rrëfim plot urtësi, më kujtoi dosjet e shumta të vakëfeve, që padrejtësisht na janë mohuar deri më sot, falë njerëzve të pandershëm, deputetëve mashtrues, drejtuesve të korruptuar të Bashkisë e institucioneve të tjera, që kanë luajtur me hakun e muslimanëve në Shkodër!

Më doli para sysh dosja e vakëfit në Zdralej, ku ne si institucion përfliemi si johumanistë, si taraf politik, si kështu e ashtu; ndërkohë që të gjithë ata që flasin pa ndalesë rreth kësaj teme, janë një mori injorantësh fodullë, ca të djathtë e ca të majtë, ca deputetë e ca fakirë të keqpërdorur për axhenda partishë politike, që ia kanë nxirë jetën Shkodrës tash 26 vite!?

M’u kujtua rasti i dosjes së vakëfit në Zogaj, vjedhja e të cilit, dikur mbrohej nga flamuri blu i partisë... Më pas, me rastin e zgjedhjeve që kaluan, nga ai rozë, i atyre që duan të ecin më shpejt..!?

Unë përherë u them të gjithëve, se kush vrapon drejt haramit, duke shkelur mbi vakëfin e shenjtë a duke bërë kompromis me të, padrejtësisht, nuk do t’i ketë vlerë shpejtësia e ecjes; mallkimi i vakëfit të shenjtë do ia prishë qetësinë, në këtë botë para asaj që vjen!

Më erdhën në hatër edhe shumë e shumë dosje vakëfesh të vjedhura, të uzurpuara, të tjetërsuara, me padrejtësitë e të cilave përballemi çdo ditë, në këtë vend-botë e tretë!?

Mbylla sytë dhe u luta: O Zot dëshmo..!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 21 mars 2016



“Europa sot,
nuk është më ajo e djeshmja.
Tashmë ka nisur të shkundë
pluhurin e fanatizmit
dhe të hapë sytë.
Evropianët panë se Islami
është fé e mendjes
dhe e logjikës, e çdo gjëje
e dobishme për njeriun,
e çdo parimi të saktë,
që mendja e shëndoshë
pranon, e çdo morali
dhe mirësjelljeje.
Këto janë sihariqe,
për të cilat pat shkruar
edhe filozofi anglez
Bernard Show, që thoshte, se:
“Nuk do të kalojë një shekull,
pa u përhapur Islami
në çdo cep të Evropës,
së bashkume gjuhën e dadit
(arabishten).”

Shejkh Ahmed Rostaj



Lavdrim Hamja

imam, xhamia e "Dy Vajzave"

NDRYSHIMI VJEN PËRMES PUNËS

në jetën e tyre.

Transmetohet se një ditë Pejgamberi (a.s) hyri në xhami dhe gjeti Ebu Umamen, të cilin e pyeti: "Çfarë të ka shtyrë të qëndrosh këtu jashtë orarit të faljes? I tha: Borxhet dhe telashet. Atëherë Pejgamberi (a.s) ia mësoi këtë lutje: O Zoti im! Mbrohem me Ty nga telashet dhe mërzia dhe mbrohem me Ty nga pafuqia dhe përtacia. Mbrohem me Ty nga frika dhe kopracia, mbrohem me Ty nga borxhet e shumta dhe dhuna e njerëzve. Tha: E bëra këtë lutje dhe Allahu ma largoi hallin dhe ma lehtësoi borxhin."

Sigurisht, që sahabiu nuk ka qëndruar vetëm në xhami duke bërë lutje dhe dua, por pas lutjes ai ka dalë dhe ka kërkuar përmes punës që Zoti (xh.sh) t'ia lehtësojë telashet dhe hallet, të cilat e kishin rënduar.

Ndryshimi vjen përmes punës, prandaj puna është fe (adhurim). Zoti i Lartësuar thotë: "Ai e bëri për ju tokën të nënshtuar, pra ecni mbi sipërfaqen e saj dhe hani nga rizku i Tij, tek Ai do të ringjallen!" - (El-Mulk: 15)

Gjithashtu thotë: "Me të vërtetë Ne ju vendosëm në tokë dhe bëmë në të për ju çdo gjë për jetesë. Pak falënderoni!" - (El-Earaf: 10)

Namazi i natës (kijamul-lejl) ka qenë obligim (farz), pastaj Zoti atë e bëri vullnetare (nafle). Zoti (xh.sh) thotë: "E diti që prej jush do të ketë të sëmurë, e të tjerë që punojnë në tokë ku kërkojnë prej mirësive të Zotit dhe të tjerë luftojnë në rrugë të Allahut." - (El-Muzemmil: 20)

Kjo nuk është thirrje për të mos u falur natën, por për të treguar dhe vërtetuar rëndësinë e punës në Islam.

Gjithmonë gjejmë kuptime të gabuara; njeri fetar e të dështuar në punën e tij me pretekstin se ai nuk interesohet veçse për adhurimin (ibadetin). Si mundet kjo gjë kur të gjithë shokët e Pejgamberit (a.s) kanë qenë që punonin. A nuk tregojnë ajetet kuranore lidhjen e besimit (imanin) me kryerjen e punëve të mira. A thua doktori i cili lehtëson dhimbjet e njerëzve nuk kryen punë të mirë?

"Dhe kur të kryhet namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë dhe kërkonit të mirat e Allahut. Përmendeni sa më

*"BESIMI NUK ËSHTË
VETËM DUKE SHPRESUAR
DHE ËNDËRRUAR,
POR AJO QË
ZEMRA BESON
DHE VEPRË E VËRTETON"*

shumë Atë, në mënyrë që të shpëtoni." - (El-Xhuma: 10)

Umer ibnul-Hattabi thoshte: "Pasha Allahun! Nuk dëshiroj të më vijë vdekja veçse në dy mënyra: Luftëtar (muxhahid) në rrugë të Zotit, ose punëtor duke kërkuar rizkun."

Kurrë nuk do të ndryshojmë në qoftë se mbesim duke u mbështetur te të tjerët. Shejkh Sharavi ka thënë: "Ai i cili nuk ushqehet nga puna e sëpatës së tij, nuk vendos për fatin e vet nga koka e tij".

Si të vendosë për fatin e vet kur ai për ushqim mbështetet tek të tjerët. Çfarë mund të themi për një ymet, kur burrat e tij shkojnë në punë për të fjetur, ose sa për të kaluar kohën, lodhin trurin për gjëra kote dhe jo për artet e prodhimit, për mënyrat se si t'i shfrytëzojnë begatitë dhe mirësitë e Krijuesit të tyre.

Së fundi, të mos harrojmë se takimi me Zotin, patjetër do të vijë, dhe kush e dëshiron atë takim: "Kush dëshiron takimin me Zotin e tij, le të punojë vepra të mira dhe të mos shoqërojë në adhurimin e Ti askënd." - (El-Kehf: 110)

"O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e tij, atëherë Allahu do ta sjellë një popull që Ai i do ata dhe ata e duan Atë, të cilët janë të përlur ndaj besimtarëve, por krenarë ndaj jo besimtarëve, që sakrifkojnë në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohen kërcënimit të askujt. Kjo mirësia e Allahut që ia jep kujt të dojë. Allahu është dhuruesi, i dijshti." - (El-Maide: 54)

Ka shumë njerëz të cilët nuk rendin duke pyetur: Cila është zgjidhja? Dhe nuk pushojmë duke iu bërë të ditur se zgjidhja është "që të ndryshojmë".. në mënyrë që Zoti të na ndryshojë realitetet e hirta. Dhe të mos bëhemi si ai që qëndron rrëzë pemës duke lutur Zotin t'i japë prej saj fruta, por vetë nuk lëviz t'i marrë ato. Kush dëshiron fruta le t'i mbjellë ato!

Po të flasim për diturinë, atë nuk e plotëson përveçse puna, por ama të mos punosh është e pamundur të ndryshosh realitetin. Allahu (xh.sh) thotë në Kur'anin Famëlartë: "Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata ta ndryshojnë veten e tyre." - (Rad: 11)

Ashtu siç transmetohet nga Pejgamberi (a.s) se ai ka thënë: "Besimi nuk është vetëm duke shpresuar dhe ëndërruar, por ajo që zemra beson dhe vepra e vërteton". - (Ibn Nexhari dhe Dejmleiu)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: "Një popull përpara jush e mashtroi shpresa duke ëndërruar në falje, derisa dolën nga dynjaja pa punuar asnjë të mirë duke thënë: Ne mendojmë mirë për Allahun. Në fakt, ata gënjyen, sepse po të kishin pasur mendim të mirë për Të (Allahun) do të kishin punuar mirë."

A nuk i ngjan gjendja e myslimanëve të sotëm këtij hadithi të Pejgamberit (a.s), sepse myslimanët shpresojnë dhe ëndërrojnë duke menduar se ndryshimi dhe përmirësimi do të vijë pa punuar për të dhe pa derdhur djersën dhe mundin e duhur. Madje edhe lutje përtojnë të bëjnë, qëndrojnë duke bërë muhabet, në vend që të zgjaten pak dhe të kërkojnë ndihmë prej Zotit të tyre, t'i dhurojnë forcë dhe fuqi për të përballuar përtacërinë dhe mungesën e seriozitetit



Hfz. Mehas Alija

Imam, B.I. "El-Hidaje", St. Gallen, Zvicër

Të dashur vëllezër dhe motra të nderuara,

Së pari falënderojmë Allahun për të gjitha mirësitë që na i ka dhuruar, e më pastaj, salavate dhe selam i dërgojmë më të mirit të njerëzimit, Muhammedit (a.s). Lusim Allahun e plotfuqishëm që familjen dhe shokët e tij t'i çmojë dhe vlerësojë me dhuntitë e Tij më të begatshme, duke mos lënë anësh as edhe ata shpirtra të denjë, e që për objektiv patën vetëm kënaqësinë e Tij dhe ruajtjen e rrugës së ndershme dhe profetike.

Të nderuar vëllezër, sot përpara jush do të mundohem të shtroj një temë nga Kur'ani i Madhërishëm, duke u kapur për disa versete kur'anore, e për të thithur nektarin e mesazhit që nxirret nga rrugëtimi i gjatë profetik e historik i disa figurave kyçe të njerëzimit në përgjithësi, dhe të fesë sonë në veçanti, (pejgamberët e Zotit), të cilët zënë një vend të veçantë në faqet e Kur'anit Fisnik.

Kur'ani nuk është një libër historik, ndonëse në përmbajtjen e tij përfshin një sërë ngjarjesh e rrëfimesh historike. Ai është përplot histori, por nuk ka karakterin e një libri të historisë. Mesazhi i historive apo rrëfimeve kur'anore nuk është që të paraqesë një sfidë artistike e narrative, siç kjo shihet në librat e zhanrit të historisë apo letërsisë dhe, as që merret me detaje, porse me to, ai synon të paraqesë klimën më të shëndoshë dhe mënyrën më të bukur për udhëzimin e njerëzimit. Me fjalë të tjera, historitë apo rrëfimet kur'anore luajnë rolin e kandilave apo llambave për të parë sa më qartë në të kaluarën

ANIJA E SHPËTIMIT TONË E KA EMRIN ISLAM

"O Zoti im, unë e ftova popullin tim natën dhe ditën"

dhe për të marrë mësimin prej saj në të tashmen, si dhe për ta forcuar të ardhmen.

Ne sot kemi ndezur një kandil dhe, nëse do Zoti, do të futemi drejtë një periudhe shumë më të largët nga ne, ndoshta me miliona vite. Kjo periudhë ka të bëjë me kohën e profetit të njohur në Islam, por edhe në fetë e tjera, e që është Nuhu (a.s).

Ndoshta te një pjesë e madhe prej nesh do të lindte një pyetje shumë e natyrshme dhe të thoshim se ç'lidhje ka Nuhu (a.s), me realitetin dhe kohën tonë, e aq më pak në realitetin shqiptar?! Por, nuk mendoj se një logjikë e këtillë do të ishte mirë e peshuar. Pësia e një mendimi do të varej nga shkëlqimi që ai rrezaton, qoftë edhe duke zënë fill në të kaluarën.

Nuhu (a.s) ishte një pejgamber i Zotit, i cili popullin e vet e ftoi në Islam dhe në besim të shëndoshë, duke kërkuar që të adhurohet vetëm Allahu. Ai këtë e bëri, ashtu siç na rrëfen Kur'ani: "natën dhe ditën". Kur ai i kaloi 950 vite duke ftuar në Islam, mbase edhe i shtyrë në moshë dhe shumë i lodhur, duke dialoguar me Zotin, tha: "O Zoti im, unë e ftova popullin tim natën dhe ditën." - (Nuh: 5)

Mirëpo, edhe përtej asaj se ky profet kaloi një kohë të gjatë në misionin e tij duke thirrur njerëzimin në besim, atij, për fat të keq, iu bashkëngjitën, jo më shumë se 80 persona. Vallë, a mund të konsiderohet ky si një dështim për një profet të Zotit? Jo, asses! Përkundrazi, sepse këta persona më pas, e sheshuan dhe e mbollën sërish farën njerëzore në sipërfaqen e tokës, pasi që ndodhi katastrofa.

Të nderuar vëllezër,

Të lexosh rrëfimin kur'anor mbi jetën dhe veprën e këtij profeti të madh dhe atë ta përmbledhësh me pak fjalë, sidomos në këto kushte të kësaj hytbeje, do të ishte, thuajse, e pamundur. Por ajo që ne synojmë të kapim me këtë rast, është fakti se si arriti ky pejgamber ta popullojë edhe

njëherë tokën? Cila ishte metoda e tij në thirrjen islame dhe në shpëtimin e njerëzimit?

Ai, në fakt, shpëtoi njerëzimin nga zhdukja. Durimi dhe puna e tij e palodhshme, rezultoi me sukses. Mjeti shpëtues i Nuhut (a.s) ishte anija. Për rrethanat kur jetoi ky pejgamber dhe populli i tij, anija ishte një shpikje e re. Askush deri më atëherë nuk kishte parë një gjë të tillë, sidomos kur ajo u ideua dhe u projektua në një vend shkretinor, ku të gjithë që e shihnin duke punuar në këtë projekt, habiteshin, madje e tallnin dhe e llogaritnin për të marrë. Ja se ç'thotë Kur'ani për këtë: "Dhe ai ndërtonte anijen, ndërsa paria e popullit të tij, sa herë që kalonte pranë tij, përqeshej me të. Ai u thoshte: Nëse talleni me ne, edhe ne do të tallemi me ju..." - (Hud, 39).

Dhe vërtetë, kur më u humbën shpresat se populli i Nuhut do të udhëzohet, u shfaq shenja që Zoti kishte caktuar për besimtarët,

Anija e shpëtimit tonë është Islami. Sa herë që të ndjemi të kërcënuar dhe të shohim me sy tufanet, duhet të afrohem pranë tij. Anije tjetër për të shpëtuar nuk ka, ndonëse dikush mundohet të na mashtrojë. Ata që mendojnë se do të shpëtojnë, duke u ngjitur në majat më të larta të qytetërimit perëndimor, duke lënë kështu rrugën dhe traditën tonë islame, e kanë shumë gabim!

përmes së cilës u bë e qartë se kishte ardhur koha e lundrimit të anijes dhe e afrimit të katastrofës. Besimtarët, së bashku me të gjitha gjallesat e tjera të çiftëzuara, filluan lundrimin, kurse jobesimtarët përjetuan cunamin e vërtetë të quajtur "Tufan". Uji mbuloi gjithçka. Nuk mbeti asnjëri në sipërfaqe të tokës, jashtë besimtarëve që ishin në anije. Triumfuan besimtarët. Zëri i Nuhut dhe i besimtarëve jehonte në falënderim dhe madhërim. Ata vazhduan të lundrojnë gjersa Zoti bëri emër që të ndalet Tufani dhe të qetësohet toka. Me ç'rast, jeta vazhdoi dhe besimi në Zotin Një dhe të Vetëm asnjëherë nuk u ndërpre. Ja, kjo është puna dhe suksesi i Nuhut (a.s). Ndonëse, në kohën e tij pak njerëz e ndoqën, megjithatë, me durimin dhe vizionin që pati, ai shpëtoi dhe ruajti gjenezën njerëzore.

Vëllezër të mi të dashur, për të mos ju marrë edhe më tepër kohë, do të doja të bëja një lidhje me atë që u tha deri tani, me kohën dhe realitetin tonë shqiptar. Fillimisht t'i parashtrojmë disa pyete: Çfarë lidhje mund të ketë kjo ngjarje me ne? Cili duhet të jetë mesazhi i kësaj ngjarjeje për ne? Çfarë roli kemi ne në kontekst të Thirrjes Islame? Cili është mjeti ynë shpëtues dhe a kemi gjasa të shpëtojmë? Dhe për kohën tonë, ç'mund të quajmë tufan, apo cila mund të jetë ajo katastrofë, e që do të na shkatërronte në rast se do ta lëshonim udhëzimin hyjnor?

Ne ishim një popull që Zotin e besonim me shumë të meta dhe duke i shoqëruar Atij rival. Mirëpo, deshi Zoti dhe u udhëzuam me Islamit dhe mesazhin e profetit Muhammed (a.s). Tani, Zoti ynë është All-llahu; feja jonë është Islami; libri ynë është Kur'ani, ndërsa pejgamberi ynë është Muhammedi (a.s). Ne filluam ta ndërtojmë anijen tonë që para gjashtë shekujsh, ndonëse edhe me ne u tallën, mbase dikush edhe sot vazhdon të tallet! Mendonin se anija jonë nuk do të mund t'iu rezistojë kushteve dhe rrethanave, por falë punës dhe vizionit që patëm, ia dolëm. Zoti na ndihmoi dhe ja tani jemi futur në procese të reja dhe synojmë të integrohemi edhe në organizma dhe shoqëri që, në gjuhë dhe fe, nuk ngjasojnë me ne.

Anija e shpëtimit tonë është Islami! Sa herë që të ndjemi të kërcënuar dhe të shohim me sy tufanet, duhet të afrohem pranë tij. Anije tjetër për të shpëtuar nuk ka, ndonëse dikush mundohet të na mashtrojë. Ata që mendojnë se do të shpëtojnë, duke u ngjitur në majat më të larta të qytetërimit perëndimor, duke lënë kështu rrugën dhe traditën tonë islame, e kanë shumë gabim! Kështu mendoi edhe djali i Nuhut (a.s). Ai mendoi se do të ngjitet në majën më të lartë të një kodre, duke shpresuar se do të shpëtojë, por një gjë e tillë ishte e kotë. Ai vetëm se e mashtroi veten dhe ata që e ndoqën pas.

Vëllezër, ne sot ndjehemi të kërcënuar nga idetë e disa intelektualëve tanë, të cilët na ftojnë që për standard jetësor të mos e kemi fenë dhe tërë atë që ajo bart. Ne jemi lodhur duke na ftuar që të besojmë në gjëra të pavlera, ndërkohë që emrin e Zotit na e kanë larguar nga zhargoni ynë i përditshëm. A thua vallë do të na e largojnë atë edhe nga zemrat tona? A thua vallë do të tolerojmë që të na bëjnë të harrojmë se kush ishim? Jo, ne nuk duhet të lejojmë të kemi një fat të këtillë zhgënjyes. Ne nuk dëshirojmë të kemi fatin e popujve pa identitet, pa fe dhe pa busull për të jetuar. Ne kemi rrugën dhe historinë tonë të lavdishme. Mjafton që të mos mashtrohemi. Ardhmëria u takon popujve që njohin vetveten dhe dinë t'i shpëtojnë njerëzit nga devijimi dhe shkatërrimi, ndërsa, pos Islamit, si sistem dhe standard shpëtues, nuk mendojmë se ka.

Si mesazh të fundit: tregimi i Nuhut (a.s) është tregim për të gjithë ne. Nuk u krijuam në këtë botë vetëm të hamë dhe të pimë, por jemi krijuar që të përmirësojmë jetën në këtë tokë dhe të vazhdojmë me thirrjen e njerëzve në të drejtën dhe të vërtetën. Islami është rruga jonë. Islami është feja, jeta dhe shpëtimi ynë.

Dhe, mjafton t'i bindemi këtij vargu kuranor, ku Zoti i Madhërishëm thotë: "E kush kërkon fe tjetër, pos fesë islame, atij kurrsesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit!" - (Ali Imran: 85)



*"Së pari, përpiguni
të jeni vetë ideal përpara
se të kërkon
për gruan ideale...
Sepse frutat nuk mund
të formohen, përveçse
pasi të kenë çelë
lulet fillimisht.
Kështu që për të gjetur
një grua si Hadixhja,
patjetër duhet të jesh
burrë si Muhammedi (a.s)!"*

Dr. Mustafa Mahmud

AKTIVITETE GJATË MUAJ



E TË BEGATA JIT MARS...





Arben Halluni, teolog

Përpara se të lindte dielli i Islamit mbi botën kanë ekzistuar popuj të mëdhenj, ku secili prej tyre pretendonte kulmin e zhvillimit dhe të civilizimit në tokë, të lirisë dhe të drejtësisë. Ndër këto popuj të mëdhenj ishin: Romakët, persianët dhe arabët. Ndërsa realiteti ishte krejt ndryshe. Secili popull ishte më i padrejtë se tjetri dhe më shkelës i të drejtave të njeriut se tjetri. Të gjitha ligjet e tyre mbronin shtresën më të lartë dhe më të privilegjuar dhe ndihmonin qëndrimin e shtresës tjetër më të madhe të popullsisë nën thundrën e shtypjes, dhunimit dhe persekutimit.

Themeli i parë mbi të cilin ngritet Islami është besimi monoteist. Ky besim dëshmon lartësimin e nderimin e njeriut, krenarinë dhe lirinë e tij për të besuar pa imponim dhe dhunë. Ndërsa paria e arabëve po përpiqej të vinte qëllimisht dyshime në besimin monoteist dhe të dialogonte me të dërguarin e Allahut (xh.sh), ai (a.s) i është kundërpërgjigjur duke i prerë rrugën e arrogancës e të mendjemadhësisë. Një herë paria kurejshite iu drejtua atij duke i thënë: "O Muhamed, na afro te Zoti yt".

Menjëherë pas kësaj Allahut (xh.sh) zbriti këto ajete kur'anore: "Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kënd, as nuk është i lindur, Dhe Atij askush nuk i është i barabartë" - (El-Ihlas). Ky besim është bazë dhe burim për vendosjen e të drejtave të njeriut. Islami përveç që i mbështet të drejtat e njeriut si krijesa më e përzgjedhur e Allahut (xh.sh), ai i mbron në bazë të principit njerëzor e njëkohësisht i përshtat ato sipas natyrës njerëzore.

ISLAMI, DËSHMI E TË DREJTAVE TË NJERIUT!...

Myslimanët janë të kërkuar që në të gjithë epokat e jetës së tyre t'i respektojnë e zbatojnë të drejtat e njeriut sipas mësimave islame, pavarësisht besimit, racës, gjuhës dhe prejardhjes së tij.

Në të vërtetë pas Luftës së Parë Botërore është vërejtur një bashkim i popujve në një organizatë ndërkombëtare për të realizuar "vetëvendosjen" për popujt e shtypur dhe të pushtuar nga politika kolonialiste e cila që mbizotëruese dhe e përhapur në shekullin e 19-të.

Po ashtu vërejmë se mbas Luftës së Dytë Botërore u ngrit Organizata e Kombeve të Bashkuara, e cila shpalli Konventën e të drejtave të njeriut. Neni i parë i saj thotë: "Njerëzit janë të lindur të lirë dhe të barabartë në lartësim dhe në të drejta. Duhet që të bashkëpunohet njeri me tjetrin me shpirtin e vëllazërimit, pa dallim prejardhje, ngjyre, race...".

Pa dyshim ky parim njerëzor i vlerësuar gëzon të gjithë botën, sepse garanton të gjithë, vendos kufirin e shfrytëzimit, persekutimit dhe dhunimit. Me këtë parim mënjanohet armiqësia e të fortit mbi të dobëtin, të gjithë janë vëllazër, jetojnë e bashkëpunojnë së bashku në paqe, në drejtësi dhe barazi.

Nga ana tjetër feja Islame 14 shekuj më parë ka vendosur principe të veçanta për të drejtat e njeriut dhe për ruajtjen e nderit të njeriut. Islami ka vendosur unifikimin e llojit të njeriut dhe raca njerëzore barazohet në origjinë dhe në zhvillim. Për këtë Allahu (xh.sh) thotë në Kur'an: "O ju njerëz! Kini frikë Allahun tuaj që ju ka krijuar prej veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe kini frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisin, se Allahu është mbikëqyrës mbi ju" - (En-Nisa: 1)

Ndërsa në një rast tjetër thotë: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër

*THEMELI I PARË
MBI TË CILIN
NGRITET ISLAMI ËSHTË
BESIMI MONOTEIST.
KY BESIM DËSHMON
LARTËSIMIN E NDERIMIN E
NJERIUT, KRENARINË
DHE LIRINË E TIJ
PËR TË BESUAR
PA IMPONIM DHE DHUNË.*

është ruajtur nga të këqijat e, Allahu është shumë i dijsëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." - (El-Huxhurat: 13)

Këto ajete kur'anore paraqesin vizionin e barazisë së njerëzve. Nuk ka dallim në ngjyrë, racë, prejardhje etj, por dallimi që ka vendosur Allahu (xh.sh) midis njeriut dhe tjetrit është se çka njeriu vepron nga veprat e mira dhe devotshmëria. Profeti i Islamit, (a.s) gjatë gjithë jetës së tij profetike ka dënuar racizmin dhe diskriminimin në besim, racë etj. Ai (a.s) nuk ka bërë dallime. Të gjithë njerëzit i ka trajtuar njësoj në të gjitha aspektet e jetës.

Shembull për këtë kemi Usama ibn Zejd, i cili një herë u përpoq që të ndërmjetësonte për një grua që meritonte dënimin e vjedhjes. Ndërsa i dërguari i Allahut (xh.sh) u zemërua nga sjellja e Usamës, që do të thotë mosvlerësim i barazisë në Islam. Profeti (a.s) iu drejtua duke i thënë: "A po ndërmjetëson në ligjet e Allahut? Kur një nga paria e beni Israilëve vidhte nuk e dënonin, kurse po të vidhte një i shtresës së thjeshtë i pritnin dorën. Për Zotin nëse kjo grua do të ishte Fatimja, vajza e Muhammedit do t'ia këpusja dorën!"

Këto pamje e të tjera si këto të mbështetura në Librin e Allahut (xh.sh) dhe në jetën e Profetit Muhammed (a.s) paraqesin dukshëm të vërtetën e të drejtave të njeriut. Me të drejtat islame bota merr frymë lirisht, përparon në çdo skaj të jetës, vendoset drejtësia, paqja dhe harmonia.

DR. HASAN TURABI DHE, (TRI PIKA)...



Mbrëmjen që kaloi u lajmërua ndarja nga jeta e mendimtarit të shquar islam, sudanezit Dr. Hasan Turabi, në moshën 84 vjeçare, pas një ataku kardiak.

Mendimtari i shquar sudanez, ishte një personazh, që jetoi në një kohë përgjumjeje dhe injorance të thellë të botës islame. Në një kohë, kur çdo gjë kishte dhe akoma ka nevojë për rishikim dhe, kur disa “perandori të rreme” të mendimit të ngurtësuar fetar duheshin dhe duhen shkallmuar pa mëshirë...

Personalitet poliedrik, që thirri për rinovimin e mendimit, usulit dhe fikhut islam, në një kohë hutimi të thellë të botës islame. Falë kallepeve të shenjtëruara nga njeriu i mangët, hoxhallarë e prijës urdhërash sufiste e selefiste, u kthyen në idhuj, si të ishin ahbarët e beni israilëve, për të cilët flet edhe Kur’ani Famëlartë, që ne nuk e lexojmë e s’dijmë ta lexojmë, xhanëm!?

Dr. Turabi thirri për mosndarjen e fesë nga politika, nga jeta, për mos transformimin e fesë, si tek të krishterët e hebrenjtë. Ai thoshte se politika ka nevojë për pendim, ekonomia dhe kultura poashtu. Por, kam përshtypjen se u keqkuptua dhe nuk u vlerësua si duhet mendimi i tij në këtë drejtim, u kryqëzua si Jehudha Askarjoti, ndonëse ai nuk ishte Judë!?

Thoshte: “Unë nuk mendoj për të ardhur në pushtet, por që pushteti të pendohet nga feja, poashtu ekonomia, papunësia, injoranca...”

Burri i urtë sudanez, ftoi muslimanët të mos përsërisin gabimet e beni israilëve në raport me fenë e me Zotin, ndonëse realitetet e botës së sotme islame dëshmojnë, se ne ia kemi kaluar modelit të beni israilëve të Kur’anit, në shumë drejtime...

Dr. Hasan Turabi, i cili u nda nga jeta në moshën 84 vjeçare, u diplomua nga Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Hartumit (Sudan), në vitin 1955. Magjistroi në Oksford (Angli), në vitin 1957 dhe doktoroi në Sorbon (Francë), në vitin 1964. Ai fliste katër gjuhë: arabishten, anglishten, frëngjishten dhe gjermanishten.

Në vite të ndryshme ai ka shërbyer edhe si rektor universiteti, ministër i jashtëm, kryetar parlamenti, ministër drejtësie, sikurse themeloi edhe partinë e Kongresit Popullor.

Ishte autor i një tefsiri të Kur’anit, i botimeve në usul, në fushën e rinovimit të politikës etj.

Natyrshëm, në rrugëtimin e tij, ai është kritikuar për mendime dhe konkluzione të ndryshme, (të cilat, pa dyshim që janë objekt studimi i dijetarëve dhe intelektualëve të thelluar), për të cilat vlen mendimi i Imam Malikut: “Të gjithëve u merret mendimi dhe u kthehet mbrapsht, përveç të zotit të këtij varri (duke bërë me dorë nga varri i Resulullllahut a.s.)”

Dr. Hasan Turabi ishte një personalitet i huaj për realitetet e sotme të botës së prapambetur, të përgjumur e primitivisht të përçarë islame..!?

Rahmet pastë!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 6 mars 2016



"Shoqërohu me të mirët,
sepse kur je larg tyre,
ata luten për ty.
Kur të hutohesh,
ta tërheqin vëmendjen.
Kur luten për veten e tyre,
luten edhe për ty.
Ata janë si yjet;
kur anija e jote humbet
në detrat e jetës,
janë aty të të udhëzojnë.
Nesër, nën hijen e Arshit do
të jenë duke të pritur. A
nuk të mjafton se,
për hir të All-llahut
të kanë dashur?"



Naim Drijaj

imam - xhamia Parrucë

Kur muslimani është në dyshim për të bërë diçka ose ballafaqohet me një problem atëherë ka dy zgjedhje: të bëjë istihare dhe istishare.

Istihare do të thotë: Të lutesh Allahun e Lartësuar të të drejtë nga vendimi më i drejtë.

Istishare do të thotë: Të konsultohesh me njerëzit e dijsëm, të mençur dhe të urtë etj. Këto dy rrugë janë edhe suneti (praktika) e Pejgamberit (a.s).

Si argument për këto dy vepra imam Neveviu në librin e tij "Rijadus-Salihin" ka sjellë dy ajete dhe një hadith.

Argumenti i parë që ka përmendur imam Neveviu është urdhri Allahut, ndërsa argumenti i dytë është lavdërimi prej Tij. Allahu (xh.sh) i drejtohet profetit Muhammed (a.s), por njëkohësisht edhe gjithë besimtarëve me këto fjalë: "Konsultohu me ata për çështje të ndryshme"¹ Në këtë ajet shohim se si Allahu, e urdhëron të dërguarin e Tij që vazhdimisht të konsultohet me shokët e tij. Jo vetëm se ai ka pasur nevojë për konsultim, por edhe për t'i mësuar muslimanëve se konsultimi është cilësi e pandarë e besimtarit.

Taberiu në komentimin e këtij ajeti thotë: "Pa dyshim se Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij që ai të konsultohet me ymetin, por edhe ymeti të konsultohet mes vete për situatat e reja me të cilat ndeshet."²

Në komentimin e ajetit të mësipërm Fahrudin Raziu përmend fjalët e Hasanit dhe Sufjan ibn Ujejes,

1. Ali Imran, 159.

2. Taberiu në tefsirin e tij.

ISTIHARE, ISTISHARE...

të cilët kanë thënë: "Vërtet Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë urdhëruar konsultimin që duhet kthyer në shprehje për ymetin."³

Ibn Kethiri, në komentimin e këtij ajeti përmend shembujt praktik të konsultimit të Pejgamberit (a.s) me shokët e tij, (dhe që janë të shumtë), siç ishte rasti i betejës së Bedrit, Uhudit, Hendekut, marrëveshjes në Hudejbije, si dhe shumë situata të tjera.

Saadi, në tefsirin e tij, në komentimin e ajetit të lartpërmendur, thotë se na parashtrohet një pyetje logjike: "Në qoftë se Allahu iu drejtua të Dërguarit të Tij, i cili është me mendim më të plotë, më i dituri, me pikëpamje më të mira, me fjalët: "konsultohu me ta", atëherë merret me mend se si duhet të veprojnë të tjerët?"

Konsultimi është fryt i bashkimit të dashurisë dhe i respektit reciprok.

Në Kur'anin Famëlartë ka një sure e cila quhet surja Esh-Shura (surja e këshillimit, konsultimit). Kjo sure ka zbritur në Meke dhe ka 53 ajete.

Në këtë sure përmendet rëndësia e konsultimit. Nëse ju o muslimanë nuk do të këshilloheni dhe nuk do të konsultoheni me njëri-tjetrin, do të dështoni në arritjen e objektivave! Kjo sure vë theksin tek rëndësia e unitetit dhe shmangia e çdo gjëje që çon në përçarje.

Surja mban këtë titull, sepse në një nga vargjet e saj këshillimi midis besimtarëve përmendet si një karakteristikë e atyre që do të fitojnë shpërblimin e Zotit në jetën tjetër. Allahu (xh.sh) thotë: "Dhe ata konsultohen mes tyre për punët e veta"⁴ Imam Katade (prej tabiinëve) ka thënë: "Kush konsultohet për hir të Allahut për një çështje të caktuar, Allahu e drejton në hajrin e Tij."

Dijetarët kanë thënë: "Kush bën istihare, nuk pendohet dhe kush konsultohet nuk dështon."

3. Fahrudin Er-Razi, në tefsirin e tij "Mefatihul-gajb"

4. Esh-Shura: 38.

*"NË QOFTË SE ALLAHU
IU DREJTUA TË DËRGUARIT
TË TIJ, I CILI ËSHTË
ME MENDIM MË TË PLOTË,
MË I DITURI,
ME PIKËPAMJE MË TË MIRA,
ME FJALËT:
"KONSULTOHU ME TA",
ATËHERË MERRET ME
MEND SE SI DUHET TË
VEPROJNË TË TJERËT?"*

Omer ibn Abdulazizi ka thënë: "Konsultimi dhe diskutimi janë dyer të mëshirës dhe bereqetit, me ndihmën e tyre mendimi nuk është i gabuar dhe as guximi nuk dobësohet." Kur bëj ndonjë hap, për të cilin jam konsultuar me njerëz kompetent jam shumë më i guximshëm dhe nuk kam frikë se kam gabuar.

Edhe sahabet e Profetit (a.s) janë konsultuar me njëri-tjetrin për çështje të ndryshme.

Omeri (r.a) në prag të vdekjes ka thënë: "Disa po më sugjerojnë ta emëroj halifin, por, unë jam i sigurtë se Allahu nuk e humb këtë fe dhe këtë hilafet, të cilën e solli nëpërmjet të dërguarit të Tij. Sidoqoftë, nëse më ndodh diçka, hilafeti mbetet nën konsultimin e këtyre gjashtë vetëve, (Aliut, Osmanit, Talhasë, Zubejrit, Sadit dhe Abdurrahman ibn Avf) nga të cilët Pejgamberi (a.s) u nda i kënaqur. Po ashtu, e di se ka njerëz të cilët e kundërshtojnë këtë, por unë kam luftuar me ta derisa e kanë pranuar Islamin. Nëse bëjnë diçka të tillë ata janë armiq të Allahut dhe të humbur..."⁵

5. Muslimi.

I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ve selem) ia ka ligjëruar ymetit të tij që t'ia parashtrijë Allahut gjërat që kanë dhe që shfaqen gjatë jetës së tyre, dhe t'i kërkojnë Atij të mirën në ato gjëra.

Xhabir ibn Abdullahu⁶ (r.a) thotë: [“Pejgamberi (a.s) na mësonte istiharen (të kërkuarit e asaj që është më e mirë) në të gjitha gjërat, ashtu sikurse na i mësonte suret e Kur’anit. Ai thotë: “Kur dikush prej jush dëshiron të bëjë diçka, le të falë dy rekate namaz (jo farz), pastaj le të thotë: “O Zoti im, Ty të drejtohem që të më orientosh me dijen Tënde për atë që është më mirë për mua. Ty të drejtohem që të më japish fuqi për kryerjen e punëve të mira, me fuqinë Tënde, kërkoj dhuntinë Tënde të pakufishme, Ti je i Gjithëfuqishëm, ndërsa unë nuk kam fuqi, Ti je Ai që posedon dituri, ndërsa unë nuk di dhe Ti je Ai që i di të fshehtat. O Zoti im, nëse sipas dijenisë Tënde, kjo punë është e mirë (hajr) për mua, për fenë time, jetën time si dhe për përfundimin tim- ose të thotë: Për jetën time kalimtare dhe për jetën e ardhshme të amshueshme- atëherë Ti më ndihmo në punën time, lehtësoma mua dhe bëje atë të begatshme. Po, nëse në dijeninë Tënde e di se kjo punë për mua është e dëmshme (sherr), në fenë time, në jetën time dhe në përfundimin tim – ose të thotë: Në jetën time si dhe jetën e ardhshme të përherëshme – atëherë largoje atë prej meje dhe më largo mua nga ajo. Më cakto mua të mirën (hajrin) kudo goftë, pastaj më bëj të kënaqur me të”. Pastaj Profeti (a.s)

6. Lindi në vitin 16 para hixhri (607 diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 78 hixhri (697 diellor). Ai ka transmetuar nga Profeti (a.s) 1540 hadithe.

tha: “Pas kësaj lutjeje e përmend dhe hallin që ka.”]’

Cfarë përfitojmë nga hadithi?

1. Istiharja bëhet me namaz dhe dua.

2. Vlera e lutjes së istihares dhe t’u përmbahemi fjalëve të saj siç janë përmendur në hadith duke mos e ndërruar atë.

3. Mëshira e Profetit (a.s) për ymetin e tij, që manifestohej duke u mësuar atyre atë që u sjell dobi në fenë dhe në jetën e tyre.

4. Lutja e istihares tregon për lidhjen e zemrës së besimtarit me Allahun e Latësuar në të gjitha aspektet.

5. Praktikimi i detyrimeve, distancimi nga të ndaluarat, praktikimi i të pëlqyeshmeve dhe lënia e të urryerave, nuk kanë nevojë për istihare.

6. Istiharja është sunnet.


7. Istiharja mund të bëhet në rastet kur njeriu është i pavendosur për diçka.

8. Në faljen e dy rekateve nuk është kushtëzuar leximi i ndonjë sureje të veçantë, apo ndonjë ajeti të posaçëm pas këndimit të Fatihës.

9. Momenti i duasë së istihares bëhet pas dhënies së selamit. (Pas namazit).

10. Istiharja nuk është e lidhur me ëndërrat. Ëndërrat mund të jenë edhe prej shejtanit, nga gjërat që përjeton njeriu gjatë ditës dhe nga Allahu (xh. sh). Pejgamberi (a.s) nuk ka caktuar numër lidhur me istiharen.

7. Buhariu.



*“Më kërkojnë
me folë për priftën,
dojnë me na përçja,
e nesër me thanë se
a pushkatuen priftënt
me dëshmitë
e hoxhallarëve.
U kam thanë
bani çka të doni,
se atë punë
s’ë baj kurrë!”*

Hafiz Musa Dërguti



Smajl Bala, *studius*

Hysen Efendi Vuthi lindi në vitin 1870, në fshatin Vuth, në një familje me tradita patriotike e fetare.

Mësimet e para fetare i mori në mejtepin e vendlindjes, ku shfaqti shenjat e një fëmije studiues e inteligjent, ndaj prindërit nuk hezituan ta dërgonin në shkollat fetare të kohës. Shkollimi i tij i mëtejshëm është i pa dokumentuar.

Haxhi Hafiz Muhamet Bekteshi ka deklaruar në biografinë e tij se “kam marrë ixhazet nga myderrizi i mirënjohur Hysen efendi Vuthi, se ai mori disa emërime në vende drejtuese të arsimit në Shkodër e deri tek emërimi i tij myderriz në gjykatën e Qarkut Shkodër.

Se kur dhe ku e filloi detyrën, edhe kjo është e pakonfirmuar. Më pas të dhënat dokumentare tregojnë se është emëruar në organet drejtuese, deri drejtues i arsimit në Shkodër. Fillimisht para shpalles së Pavarësisë së Shqipërisë në rolin e drejtorit të kësaj drejtorie. Mbas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, po në këto organe, si kryetar i komisionit të arsimit të Prefekturës Shkodër. Në vitin 1919 është inspektor (drejtor) i IASH (Inspektoria e Arsimit Shqiptar), më pas inspektor dhe mësues besimi i IASH. Në librin “Në kujtim të brezave”, shkruhet: “Hysen Ef. Vuthi ka qenë myderriz i njohur dhe kryetar i komisionit të arsimit në Shkodër e më vonë inspektor arsimit për besimin fetar në seksionin e arsimit të Shkodrës.”

Veprimtaria e tij nuk kaloi pa lënë gjurmë dhe dha frytet e saj, duke dhënë kontributin e tij të gjithanshëm në zhvillimin e arsimit në Shkodër. Ai është ndër kuadrot e para të arsimit të Prefekturës së Shkodrës pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, karrierë të cilën ai e vazhdoi për vite të tëra.

Me riorganizimin e drejtorisë së përgjithshme të arsimit në Shkodër, në

HYSEJN EF. VUTHI - VEPRIMTAR I SHQUAR I ARSIMIT SHQIPTAR (1870-1923)

gusht të vitit 1916 vazhdoi të jetë ndër drejtuesit kryesorë të kësaj drejtorie, në drejtimin e IASH që në vitin 1919.

Hysen Ef. Vuthi ishte hoxhë i nderuar. Ai punoi dhe luftoi që arsimit në Shkodër dhe në Shqipëri të marrë zhvillim e të hapen shkolla të reja, kryesisht në gjuhën shqipe. Në këto shkolla jepeshin edhe mësimet besimi nga hoxhallarët më të përgatitur. Këtë përkujdesje ai e pat edhe për besimin katolik, ku, në bashkëpunim me arqipeshkëvinë e Shkodrës, emëruan në këto shkolla priftërinjtë-mësues ndër më të aftët.

Ishin vitet e para të hapjes së shkollave shtetërore, të cilat, me kontributin e propagandimit të tij, së bashku me drejtorin e saj, Luigj Gurakuqi, bënë të mundur që të mbusheshin me nxënës. Në krye të kësaj detyre, ka qëndruar deri në vitin 1920. Në këtë vit është emëruar drejtor i shkollës (mësonjëtores) në Rus-Haslikaj, me një pagë 220-300 fr.ari në muaj, pagë kjo, që vërteton nivelin e lartë profesional që zotëronte dhe angazhimin e tij në punët e përditshme. Në një letër dërguar Ministrisë së Arsimit në Tiranë, IASH shkruan: “Ai (Hysen ef. Vuthi-shënimi im, S.B.) ka qenë ndër më të përmendurit hoxhë të këtij qyteti për dije mbi besimin fisnik.”

Në rolin e drejtorit të shkollës ai gjendej gjithnjë në krye të detyrës. Ai vuri në punë të gjitha aftësitë dhe përvojën e madhe që kishte për një periudhë të gjatë në arsim. Në korespondencën që ka krijuar me IASH dhe me MA në Tiranë, del i qartë angazhimi i tij për të krijuar e aplikuar metoda mësimdhënieje sa më bashkëkohore, përmes të cilave ai synonte një përvetësim sa më të mirë programeve lëndore nga masa e nxënësve dhe një kalueshmëri sa më të lartë nga ana e tyre. Synonte që mësuesit të ishin sa më të përgatitur nga ana pedagogjike e shkencore, të aftë që në komunikim me nxënësit e prindërit të shfaqnin kulturë qytetare, që gjithnjë të ishin shembull në sytë e komunitetit, që nga veshja e paraqitja e jashtme.

Në shkollat ku punoi e drejtoi kërkonte nga shteti e punonte bashkë me stafin pedagogjik që lokali i shkollës së tij të ishte sa më i përshtatshëm për mësim, që të përmbusheshin sa më mirë të ishte e mundur kërkesa për bazë materiale didaktike, kuptohet në



HYSEN EF. VUTHI

vartësi të mundësive të kohës. Në letrën që i dërgon IASH, Hysejn efendi Vuthi i kërkon “rrethimin e shkollës dhe të oborrit të saj, të bëhet dera e hyrjes dhe e daljes, për të ruajtur nxënësit që të mos dalin në rrugë për të parandaluar ndonjë aksident të mundshëm, meqë shkolla ishte bri rrugës, por edhe për të forcuar disiplinën në shkollë”. Pra, të gjitha ato që kërkoheshin për një shkollë, ai dëshironte t’i realizonte.

Gjatë ushtrimit të këtyre detyrave, Hysejn efendi Vuthi ka qenë edhe myderriz në gjykatën e rrethit dhe anëtar i gjykatës së rrethit të Shkodrës.

U nda nga jeta në krye të detyrës më 31/03/1923.

Veprimtaria e Hysen Ef. Vuthait në shërbim të arsimit është vlerësuar edhe pas vdekjes. IASH i ka propozuar MA në Tiranë që për kontributin e gjatë në arsim, familjes së tij t’i lidhej pension. Presidenti i Republikës, Sali Berisha, e ka dekoruar Hysen Ef. Vuthain (pas vdekjes), me dekretin nr. 811, datë 2/04/1994.¹⁾

1.) Për jetëshkrimin e Hysejn Ef. Vuthait, autori ka shfrytëzuar këto dokumenta: MSHS, fondi i IASH, viti 1919-20, 1119/XIV, dt. 26/09/1920, të IASH. Kuadri i arsimit të prefekturës së qarkut të Shkodrës, që e emëron AISH 944/XIV, dt. 22/03/1921, që e emëron IASH dhe mësues besimi në IASH, me 1074/II, dt. 2/04/1921 dhe 1062/II, dt. 29/09/1921, që vërteton emërimin e Hysen Vuthit drejtor të shkollës së Rusit (Rus-Haslikaj), viti 1920-21. Me 32/XIV, dt. 7/10/1921, që vërteton se është inspektor dhe mësues besimi në IASH. 1168/II, dt. 5/10/1921, me 2/03/1923, që vërteton se ka ndruar jetë Hysen Vuthi. Viti 1924-1925, vërteton me shkresë të dt. 3/04/1923 se ai ka pasë rrogën 220 fr.ari në muaj.



Gëzim Kopnai, Myfti i Pukës

Sipas të dhënave xhamia e fshatit Iballë¹ është një ndër xhamitë më të vjetra të Myftinisë së rrethit Pukë. Rreth viteve 1800 numërohet të kenë qenë rreth 30 shtëpi myslimane të ndarë në dy fise: Thaç dhe Zotni. Edhe sot xhamia ndodhet tek e njëjta lagje, e cila quhet “Lagjja e Zotnive”. Ajo është e vendosur në mes të shtëpive. Xhamia e fshatit Iballë ka qenë një katëshe. Brenda saj gjendej minberi, hajati dhe vendi i grave.

Xhamia ka qenë e ndërtuar me gurë (sipas të dhënave gojore të ardhura nga Kosova) dhe e mbuluar me tjegull.² Fillimet e xhamisë datojnë me ardhjen e Perandorisë Osmane në rrethin e Pukës. Mjaft ndikim kanë luajtur tregtarët myslimanë që përshkruanin rrugën Gjakove-Has-Pukë-Shkodër.³ Më

1. Iballë; Fshati Iballë është një ndër fshatrat më të largëta të rrethit të Pukës dhe ndodhet mbi 752 m mbi nivelin e detit. Qendra e fshatit shtrihet në një fushe mjaft të bukur. Përmes fshatit kalon një përrua që mban ujë në dimër e në verë. Myslimanët janë të ndarë në dy fise: Thaç dhe Zotni (të cilët janë fisi i Kabashit). Fisi i Thaçit është i përbërë nga dy besime mysliman dhe katolik, ndërsa fisi i Zotnive është mysliman.

2. Thuhet se gurët e xhamisë Iballë kanë qenë gurë të gdhendur mirë dhe me forma të ndryshme madje edhe sot, me fanatizëm banorët ruajnë një të tillë.

3. Kjo rrugë ndryshe quhet rruga e Gjakovës ose Rruga e Madhe. Ajo kalonte në disa vende

HISTORIKU I XHAMISË SË FSHATIT IBALLË, PUKË

vone xhamia Iballë është mirëmbajtur nga vete myslimanët e kësaj zone.

Në këtë xhami ka funksionuar edhe Mejtepi i xhamisë Iballë. Ai u ndërtua rreth vitit 1900, ku si fillim u ndërtua një “odë” e veçantë, e cila shërbente si Mejtep për të mësuar fëmijët myslimanë. Mejtepi ka vazhduar deri në vitin 1920. Gjatë viteve 1916 në Mejtepin e Xhamisë Iballë kishte të regjistruar rreth 12 djem dhe 2 vajza të moshës 8-14 vjeç. Në këtë Mejtep mësohej këndim në gjuhën shqipe si edhe mësim për namazet, mësim të “ashereve” kur’anore. Nga të dhënat mësues në këtë “Mejtep” ka qenë imami i xhamisë, Hoxha i Madh, Isuf Hoxha dhe më pas Sadik Hoxha.

Ky Mejtep, përveç mësimave fetare, ka shërbyer edhe si vend takimi për Pleqtë e Urtë, të cilët herë herë bashkoheshin dhe këndonin këngë me çifteli dhe këngë të zonës. Kjo ndodhte disa herë në vit, sidomos në muajin e “Mevludit”, Ramazanit etj, ku imami i xhamisë Iballë bashkonte burrat e fshatit dhe gjatë këndimit të “Mevludit” përveç ilahive, salavateve, këndonin këngë patriotike si dhe bënin kuvende të ndryshme.

Ndërsa për festat e Bajrameve, si në vendet e tjera, edhe në këtë fshat ishte zakoni vizita nëpër shtëpia. Vizitë bënin edhe fëmijët. Imamët e parë të xhamisë Iballë mësohet të kenë qenë “imamët lëvizës”, të cilët në disa raste ishin turq dhe kosovarë si për

në rrethin e Pukës që përshkonte fshatrat, si: Kabash, Rrapë, Kryezi (në fshatin Kryezi kalonte edhe Rruga e Madhe që lidhte edhe fshatin Iballë. Sipas të dhënave gojore, “Myslimanët e Iballës, dhe jo vetëm, kanë ngrënë e pirë në shtëpitë e Agve të Kryeziut.” Ka pasur raste që edhe kanë buajtur e pushuar, veçanërisht në kohën e dimrit.), Flet, Dardhë etj.



shembull nga qyteti i Gjakovës dhe i Prizrenit. Ndërsa imamë vendali ishin: Isuf Hoxha, Sadik Hoxha, Hoxhë Bisha, si dhe Sherif Arifi.

Me rilejimin e fesë edhe kjo zonë filloi të angazhohet në çështjet islame duke zgjedhur anëtarët e këshillit të xhamisë Iballë si dhe anëtarin e Këshillit të Myftinisë së rrethit Pukë për zonën Iballë. Në vitin 2004 duke dhënë shembullin e tij personal, Ismet Kapeta⁴ restauroi xhaminë e fshatit Iballë duke ndërtuar edhe minaren e xhamisë. Pas rikonstruksionit, namazin e parë të Fitër Bajramit e ka kryer H. Ibrahim Hoxha⁵.

4. Ismet Kapeta, është nip me shtëpinë e Hoxhallarëve Zezaj, Pukë, Ibrahim dhe Elez Hoxha.

5. H. Ibrahim Hoxha, asokohe Myfti i Rrethit Pukë.



U INAUGURUA XHAMIA E RE NË FSHATIN MJEDË

Ditën e xhuma, më 26 shkurt 2016, Myftinia Shkodër dhe Fondacioni “Mirësia”, organizuan ceremoninë e inaugurimit të xhamisë së re në fshatin Mjedë.

Xhami e re e Mjedës u realizua falë bashkëpunimit me Fondacionin “Mercy International” dhe sponsorizimit të zonjës Fatima Salimin nga Kuvajti.

Shiritin e inaugurimit e preu vetë donatorja e kësaj xhamie, së bashku me familjarët e saj, duke dhuruar emocione të bukura dhe kënaqësi për krejt të pranishmit.

Në ceremoninë e hapjes së xhamisë së re dhe faljes së xhumasë së parë ishin edhe drejtues të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, nën drejtimin e nënkryetarit H. Bujar Spahiu, familjarët e donatores nga Kuvajti, përfaqësues të ambasadës kuvajtiane në vendin tonë, drejtues të fondacioneve dhe shoqatave të ndryshme bamirëse islame, Myftiu i Malësisë së Madhe, si dhe besimtarë të shumtë të zonës.

Në fjalën e tij të rastit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, pasi falënderoi zonjën Fatima Salimin, e pranishme në xhami, si dhe z. Korab Kaja, për bashkëpunimin e



frutshëm me Fondacionin “Mirësia”, tha se xhamia e re e Mjedës është një shenjë nga Zoti i gjithësisë, që dëshmon nëpërmjet shtëpisë së Tij, dashurinë dhe mëshirën e madhe për banorët e kësaj zone.

Myftiu tha se përtej trysnisë së të shkuarës ateiste, afetarizmit dhe islamofobisë së të sotmes, Islami lulëzon edhe nëpërmjet afrimit të rinisë dhe brezit të ri me fenë dhe mësimet e saj.

Ceremoninë e përshëndeti edhe nënkryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, që tha se kjo xhami e re në

fshatin Mjedë është një derë e re drejt adhurimit të Zotit, si dhe një vatër e edukimit me vlerat e larta të Islamit. Ai falënderoi donatoren dhe tha se ky veprim i saj dëshmon në vetvete madhështinë e Islamit, që i bën muslimanët anëmbanë botës vëllezër besimi!

Ndërsa z. Korab Kaja, drejtori i Fondacionit “Mirësia”, pasi uroi të pranishmit për këtë mirësi të madhe, u lut që kjo xhami të jetë një simbol i rimëkëmbjes së vlerave të Islamit në këtë zonë. Ai falënderoi donatorin e këtij vakëfi, rahmetliun Ragip Rrema dhe dhuruesen e fondit për ndërtimin e xhamisë, znj. Fatima Salimin, që e ndërtoi këtë xhami për shpirtin e të shoqit Abdurrahim Es-Suvejdi.

Në emër të Fondacionit “Mercy International”, përshëndeti përfaqësuesi i saj, z. Omar El-Kenderi, që vlerësoi kontributin e Shtetit të Kuvajtit dhe fondacioneve të saj bamirëse për zbatimin e projekteve bamirëse në Shqipëri. Ai vlerësoi popullin shqiptar si bujar, mikpritës dhe bashkëpunues në rrugën e veprave të dobishme komunitare.

Ceremonia u pasua nga falja e namazit të xhumasë së parë në xhaminë e re, pas hytbes së mbajtur nga H. Bujar Spahiu.



Paraditën e së shtunës, më 27 shkurt 2016, është zhvilluar mbledhja e radhës e Këshillit të Myftinisë Shkodër.

Në qendër të këtij takimi ka qenë institucionalizimi i bashkëpunimit me Bashkësinë Islame të Ulqinit, gjallërimi i jetës kulturore islame në Shkodër, si dhe është diskutuar rreth disa tematikave të ngushta që lidhen me pronat dhe zhvillimin e tyre.

Në fjalën e tij, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka shpjeguar se prej kohësh i është propozuar Bashkësisë Islame të Ulqinit nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi në rang institucional. Ai ka theksuar se është gjetur mirëkuptimi me Këshillin e Bashkësisë Islame të Ulqinit dhe Kryeimamin e nderuar, z. Ali Bardhi dhe se pas diskutimit dhe dakortësisimit mbi pikat e marrëveshjes së bashkëpunimit dhe binjakëzimit, do të zhvillohet edhe ceremonia e nënshkrimit të saj.

Në këtë mbledhje është diskutuar edhe për domosdoshmërinë e zhvillimit

KËSHILLI I MYFTINISË DISKUTON BASHKËPUNIMIN ME B.I. ULQIN



të aktiviteteve me karakter kulturor islam, me qëllim nxjerrjen në pah të kontributit të madh të dijetarëve tanë dhe shpirtit islam në trashëgiminë tonë kombëtare.

Këshilltarët kanë rënë dakord edhe në lidhje me disa tematika të ngushta që lidhen me zhvillimin e vakëfit dhe kërkesat e ndryshme të ardhura në zyrat e Myftinisë Shkodër.

PËRFUNDOI CIKLI 1 I DERSEVE ME TEMË: “FEJA ËSHTË KËSHILLË”

Mbrëmjen e së enjtes, më 10 mars 2016, në xhaminë e “Dy Vajzave”, u zhvillua mbyllja e ciklit të parë të derseve me temë “Feja është këshillë”, që u organizua në disa prej xhamive të Shkodrës, në datat 29.2 - 10.3. 2016, sipas një programi të lajmëruar më parë nga Myftinia Shkodër.

Cikli i parë i derseve në fjalë u zhvillua në xhamitë: “Ebu Bekër”, Dërgut, Rus, Kiras, Mes-Myselim, Perash, Medrese dhe në xhaminë e “Dy Vajzave”, ku ligjëruan imamët e nderuar: Idmir Plaku, Lavdrim Hamja, Naim Drijaj, Durim Kasemi, Adil Cukali, Ervil Kuçi dhe Ruzhdi Plangaj.

Në mbrëmjen e mbylljes së këtij cikli të dobishëm vasesh, në xhaminë e “Dy Vajzave”, ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili falënderoi imamët dhe xhematet për angazhimin e tyre dyjavor në këtë seri mbrëmjesh fetare me ligjërata e këshilla të dobishme fetare.

Myftiu vlerësoi këto tubime si mundësi e marrjes së këshillave të dobishme fetare, si dhe si një shtysë e mëtejshme për rritjen e harmonisë në



mesin e muslimanëve.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj, i cili shprehu vlerësimet e tij për këto tubime të dobishme dhe theksoi se kjo eksperiencë duhet të përhapet edhe në qytetet e tjera, si një dobi për muslimanët e vendit tonë.

Kjo mbrëmje fetare vazhdoi me këshillat e dobishme fetare të imamëve të nderuar Durim Kasemi dhe Naim Drijaj, të cilët dhanë mesazhe dhe udhëzime të dobishme për besimtarët.

Në fund, imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja, falënderoi të pranishmit dhe Myftininë Shkodër për këtë atmosferë, si dhe shprehu dëshirën që kjo iniciativë e përsëritur të vazhdojë edhe në xhami të tjera.

Për të pranishmit u shpërnda literaturë e dobishme fetare islame në gjuhën shqipe, mundësuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC) në Tiranë.



المهجة الإسلامية الألبانية
دار الإفتاء - مدينة شُودرا
KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËSË
MYFTINIA SHKODËR

Daut Boriçi, korifeu i abetareve shqip,
në abetaren e tij me shkronja arabe,
të vitit 1861, udhëzon pastër dhe shqip:



**“Mos rri pa punë – Shko n’shkollë – Mos prito!
Ndigjo këshillat e mira – Kur t’flasësh, mendo – Mos rrej!”
“Xen me shkrue shqip”!**

**MIRËNJOHJE DHE RESPEKT
PËR MËSUESIT DHE EDUKATORËT TANË!**

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org